



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 29.06.2021

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të disa akteve zhvillon konsultime.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak të Projekt-Vendimit dhe Relacionit **“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB 127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME DHËNIEN NË PËRDORIM TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT”**, të propozuar nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë Durrës, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës ([www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail : [keshillidurres@gmail.com](mailto:keshillidurres@gmail.com), brenda 20 ditëve nga publikimi në faqe.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

**SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK Durrës**

**Dorina Milja**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE**

**PROJEKTVENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB 127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE  
TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME  
DHËNIEN NË PËRDORIM TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR  
DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PAS PROGRAMIT  
MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 9975 date 28.07.2008 “Per taksat kombetare” i ndryshuar, Ligjit nr.9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Per Planifikimin e territorit” i ndryshuar, Ligji nr.10465 date 29.09.2011 për “Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8378 dt 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr.9936 dt 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, legjislacionit të aplikueshem ne fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e ndryshimit të ndryshimit të VKB 127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” si më poshtë vijon:
  - Pas tabelës nr. 41 të Vendimit nr. 127 date 24.12.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021" Shtohet paragrafi si më poshtë :

"Tarifa për dhënien në përdorim të mjediseve sportive të shkollave” .

Tarifa për dhënien në përdorim të mjediseve sportive të shkollave të destinuara për organizimin e veprimtarive sportive (palestra sportive) është 200 lekë/orë.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtyre tarifave do të jetë Qendra Ekonomike e Arsimit, dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat do të kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Durrësit.

2. Ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**DREJTORIA E TAKSAVE  
DHE TARIFAVE VENDORE**  
Drejtör

**Luan Dajko**

**DREJTORIA E ARSIM- KULTURË  
RINI-SPORTE DHE KOM.FETARE**  
Drejtör

**Adrian Gurra**

**DREJTORIA LIGJORE**  
Drejtör

**Arben Isaku**

**ZËVENDËSKRYETAR I BASHKISË**

**Emiriana Sako**

Koncept: *D. Murataj*

Pranoi: *V. Manushi*

Miratoi: *A. Isaku*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE  
SEKTORI I SPORTEVE**

**RELACION**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB 127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE  
TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME  
DHËNIEN NË PËRDORIM TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR  
DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PAS PROGRAMIT  
MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT**

**KËSHILLIT BASHKIAK  
KËTU**

Të nderuar këshilltarë!

Nëpërmjet këtij relacioni Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare propozojmë fillimin e procedurave për dhënie në përdorim të mjediseve sportive të shkollave të destinuara për organizimin e veprimtarive sportive (palestra sportive). Mjediset sportive që kërkohet të jepen në përdorim janë pronë e Bashkisë Durrës.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkitë krijojnë të ardhura ndër të tjera edhe nga e dhënia në përdorim e pronave publike vendore. Neni 54 i ligjit “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma “e”, përcakton se Këshilli Bashkiak “... miraton tjetërsimin ose dhënie në përdorim të pronave të tretëve... Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare nisur edhe nga interesi që subjekte të ndryshme të licensuara për zhvillimin e aktiviteteve sportive kanë shprehur për marrjen në përdorim të ambjenteteve të shkollave publike propozon të vendosim një tarifë për marrjen në përdorim të Ambjentet sportive që do të shfrytëzohen pas orës mësimore deri në orën 20:00 të çdo dite të javës.

Me qëllim që të mbulohen shpenzimet e ndryshme që realizohen gjatë zbatimit të projektit si psh. Energji elektrike, ujë, pastrim etj. si edhe në mënyrë që të ardhurat të shërbejnë në tërësi për mirëmbajtjen e shkollave nëntëvjeçare dhe gjimnazet propozojmë që Çmimi për marrjen në përdorim të jetë 200 lekë/orë. Kjo tarifë të shtohet në Paketën Fiskale e cila është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 127 datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021”.

Struktura e ngarkuar për përmbledhjen e këtyre tarifave do të jetë Qendra Ekonomike e Arsimit, dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat do të kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Durrësit. Të ardhurat do të përdoren për mirëmbajtjen e ambjentit, me qëllim ruajtjen e saj nga degradimi. Marrëdhëniet midis përdorues, Bashkisë në cilësinë e pronarit dhe Institucionit arsimor do të rregullohen nëpërmjet marrëveshjes trepalëshe.

Këtë aktivitet përdoruesi do ta ushtrojë pas orarit të mësimit, duke mos penguar funksionimin normal të aktiviteteve sportive të shkollës gjatë orarit mësimor.

Një nga kushtet për marrjen në përdorim të palestrave sportive do të jetë dhe detyrimi i përdoruesit, që në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, të ofrojë për nxënësit e shkollës, ushtrimin e sportit të disiplinave të ndryshme.

Mendojmë se ushtrimi i aktivitetit në mjedisin sportiv të shkollës, zgjidh këto probleme:

- Do t'i shërbejë procesit mësimor, konkretisht kurrikulës mësimore të orës sportive, duke përmirësuar kështu orët e edukimit fizik, zhvillimit të orës së edukimit fizik sa më komod, përmirësimin e cilësive fizike, teknike, kapacitetin jetësor të çdo nxënësi, me synim rritjen e cilësisë fiziko-sportive.
- Përdorimi i mjedisin sportiv nga përdoruesi do të bëhet pas orarit mësimor.
- Dhënia në përdorim të mjedisit sportiv pas orarit të mësimit, do të sjellë dhe përfitime të tjera. Të gjitha shërbimet si për riparimin të tapeteve, mirëmbajtjen e parketit, të shtyllave, koshave, rrjetave, ndriçimi etj, element këto përbërëse të një ambjenti sportiv, do të realizohen nga ana e përdoruesit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj !

**DREJTOR I ARSIM, KULTURE, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE**

**Adrian Gurra**

**DREJTOR I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**Luan Dajko**